



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT-ODBOR ZA USLOVNI OTPUST-CONDITIONAL RELEASE PANEL

PLK. D. nr. 501/22

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT, i përbërë nga Beshir Islami, kryesues i Panelit, Delushe Halimi dhe Shpresa Hasaj Hyseni, anëtarë të panelit, me pjesëmarrjen e Adelina Jusufi, u.d. koordinatore e panelit, duke vendosur përkritazi me kërkesën e datës 17.08.2022, për lirim me kusht, të parashtruar nga B. O., për shkak të veprës penale detyrim nga neni 267 par.2 të KPK-së, i gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjet, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, APS.nr.43/2020, të datës 26.02.2021, në pajtim me nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06-L-074), nenin 116, 117, 118, 119 dhe 197 të Ligjit (08/ L-132) për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenet 13, 14, 25 pika 1.2 si dhe 34 të Rregullores së miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Ref: KGJK, nr. 01/39) mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht, në seancën e mbajtur më 12.10.2022, në selinë e KGJK-së në Prishtinë, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. APROVOHET** kërkesa për lirim me kusht për të dënuarin B. O., i biri i M. dhe i nënës A., e lindjes K., i lindur me ..., në fshatin Zh., ku edhe e ka vendbanimin, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- II.** B. O. do të lirohet me dt. 14.10.2022, dhe do të jetë nën mbikëqyrje të Shërbimit Sprovues të Kosovës deri me dt. 03.09.2023.

Arsyetim

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, APS.nr.43/2020, të datës 26.02.2021, B. O., për shkak të veprës penale detyrim nga neni 267 par.2 të KPK-së, i gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjet.

Me rastin e shqyrtimit të kërkesës, paneli për lirim me kusht ka shqyrtuar raportin përmbledhës të përpiluar nga ekipi profesionist i Shërbimit korrektues të Kosovës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 par. 6 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr. 08/ L – 132.

Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave të paraqitura në shkresat e cekura më lartë, paneli ka gjetur se:

Lirimi i zakonshëm për të dënuarin është caktuar me 03.09.2023. I dënuari deri me tani ka vuajtur 4 vjet e 1 muaj e 9 ditë, ndërsa i kanë mbetur edhe 10 muaj e 21 ditë, të cilat do të mbikëqyren dhe kontrollohen nga Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Në raportin përmbledhës të Qendrës Korrektuese konstatohet se i dënuari ka treguar sjellje të mira, është angazhuar me punë, punën të cilën e kryen pa ndonjë vërejtje, e pranon veprën dhe shfaqet i penduar. Procesi i risocializimit sipas Ekipit profesionist të Qendrës Korrektuese tek i dënuari mendohet se mbajtja e dënimit ka ndikuar pozitivisht, procesi ka rrjedhur mirë.

Prandaj, Paneli vlerëson se tani është arritur qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenit 5 dhe 6 të LESP-së, lidhur me nenin 38 të KPRK-së, duke marrë parasysh faktin se i dënuari ka treguar sjellje të mira, qëndrimi i tij personal në raport me vuajtjen e dënimit dhe efekti i burgosjes tek i dënuari ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e tij, por gjithashtu edhe koha e mbetur në përpjesëtim me kohën e vuajtur ngase ky person ka vuajtur me shume se 2/3 e dënimit qysh prej datës 03.01.2022, si dhe premtimi i dhënë zyrtarit të Shërbimit Sprovues të Kosovës së do të bashkëpunojë me këtë shërbim deri në përfundimin e mbikëqyrjes së lirimimit me kusht këto janë rrethana për të cilat konsiderohet se është arritur qëllimi i dënimit. Paneli konsideron se me një mbikëqyrje efektive i dënuari me lehtësi do të ri-integrohet në familje dhe shoqëri në pajtim me ligjin.

Paneli vendosi që ta lirojë me kusht personin e dënuar B. O., ai do të lirohet me kusht me dt.14.10.2022 (e premte ora 16:00), nën kushtet e mëposhtme:

Brenda pesë (5) ditësh nga data e lirimimit nga burgu të lajmërohet në Drejtorinë Regjionale të Policisë së Kosovës, përkatësisht të Shërbimit Sprovues;

1. të raportojë rregullisht në Shërbimin Sprovues deri me 03.09.2023;
2. në rast të ndërrimit të vendbanimit ta njoftoj policinë dhe shërbimin sprovues;
3. të mos tentojë që të udhëtoj jashtë Shtetit, pa miratimin e Panelit për Lirim me Kusht;
4. të jetë me i kujdesshëm me sjelljet e tij në të ardhmen.

Udhëzim për Qendrën Korrektuese:

Qendra Korrektuese ku personi i dënuar është duke vuajtur dënimin duhet të ndërmarr veprimet si në vijim:

- I.*** komplet Aneksin 2 – Komunikimi i Lirimimit me Kusht Gjykatës kompetente;
- II.*** komplet Aneksin 2a – Komunikimi i Lirimimit me Kusht Policisë;
- III.*** komplet Aneksin 2b – Komunikimi i Lirimimit me Kusht Shërbimit Sprovues;
- IV.*** i shpjegon plotësisht personit të dënuar kushtet e lirimimit (obligimet ligjore mbi zbatimin e vendimit - kushtet mbi raportimin dhe pasojat e krimeve tjera).

Udhëzim për Drejtorinë Regjionale të Shërbimit Sprovues:

Drejtoria Regjionale e Shërbimit Sprovues duhet të ndërmarr veprimet si në vijim:

- I.*** Drejtoria përkatëse regjionale e Shërbimit Sprovues duhet që të raportoj jo më larg së tri (3) javë nga data e lirimimit të të dënuarit, gjithashtu e mban të informuar panelin me raporte periodike deri në skadimin e kohës së rregullt të dënimit.
- II.*** Zyrtari Sprovues udhëzohet që të fokusohet mbi orientimin e të liruarit me kusht në kuptim të respektimit të kushteve të caktuara sipas aktvendimit të panelit. Duke u bazuar në kohën e lirimimit të zakonshëm të dënimit për të dënuarin, ai është dashur që të lirohej me datën 03.09.2023. Prandaj, e rekomandojmë shumë atë që të mban me vete këtë

aktvendim mbi lirimin me kusht gjatë tërë kohës deri në skadimin e liritimit të tij me kusht, që është caktuar me 03.09.2023.

Personi i cili është liruar me kusht është i njoftuar me faktin se:

- *lirimi me kusht mund të revokohet, dhe në disa raste duhet të revokohet, nëse i dënuari, gjatë liritimit me kusht kryen një apo me shumë vepra penale (Neni. 91 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës – Kodi nr. 06/L-074);*
- *i liruari me kusht është i obliguar që të njoftoj policinë dhe shërbimin sprovues brenda 5 (pesë) ditëve të liritimit, për vendqëndrimin e përkohshëm të tij apo saj gjatë periudhës së liritimit me kusht;*
- *gjithashtu personi i liruar me kusht është i obliguar që të raportoj në Shërbimin Sprovues gjatë periudhës së liritimit me kusht;*
- *Nëse i liruari me kusht e ndërron vendbanimin, është i obliguar që të njoftoj Policinë dhe Shërbimin Sprovues;*
- *nëse dështon të informoj apo raportoj siç u përmend me lartë, paneli për lirim me kusht mund t'a revokoj vendimin për lirim me kusht (neni 119 paragrafi 4 i Ligjit rr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale lidhur me nenin 36 të Rregullores së miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Ref: KGJK, nr. 39) mbi Organizimin dhe Funksionimin e Panelit për Lirim me Kusht;*
- *gjithashtu nëse dështon që të raportoj para SHSK-së siç përcaktohet në vendim, paneli mund ta revokoj vendimin për lirim me kusht (Neni 119 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale).*

Nga sa u tha më lart e me zbatimin e nenit 25 pika 1.2 të Rregullores nr. 01/39 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

**PANELI PËR LIRIM ME KUSHT
PLK. D. nr. 501/22 , datë 12.10.2022**

U.d. Koordinatore e Panelit

Adelina Jusufi

Kryesues i Panelit

Beshir Islami

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 117 par.16 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk është e lejuar ankesa.